



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

Nr. 15500 Prot.

Lezhë, më 03.08.2026

URDHËR

Nr. 622, Datë 03.08.2026

**“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR  
PROJEKT-DOKUMENTIN E PBA-SË 2027-2029 DHE BUXHETIT VJETOR 2027  
(FAZA E DYTË)”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, Ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Ligjit Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Vendimin Nr.393 datë 18.07.2022 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lezhë” si dhe Vendimin Nr.27, datë 12.01.2026 “Për miratimin e Planit Vjetor 2026 të Kalendarit të Konsultimeve Publike për Bashkinë Lezhë”, shkresen Nr.21229/3 Prot. datë 22.12.2025,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e kalendarit të konsultimeve publike për projekt-dokumentin e PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2027, për të gjitha njësitë administrative në Bashkinë Lezhë.
2. Konsultimet do të realizohen sipas kalendarit bashkëngjitur, në koordinim me Këshillin e Bashkisë Lezhë.
3. Të ngarkohet Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropës, Emigracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës për koordinimin e procesit të konsultimit dhe informimit rreth takimeve si dhe transparencës për publikun.
4. Të ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit si dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për vëndosjen në dispozicion të dokumentave për publikim si dhe mbajtjen e procesverbaleve të takimeve dhe listëprezencës si drejtori përgjegjëse për hartimin e projekt-akteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Pjerin NDREU**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV.KRYETARI**  
**Brikena VUKSANI**



**KALENDARI I KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PROJEKT-DOKUMENTIN E PBA-SË 2027-2029 DHE BUXHETIT  
VJETOR 2027 (FAZA E DYTË)**

| Nr. | Aktiviteti                                                                                                                                                                                                                                                                 | Objekti i takimit,<br>konsultimit publik                                                      | Data       | Vendi                                            | Ora   | Mënyra          |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------|------------|--------------------------------------------------|-------|-----------------|
| 1.  | Konsultim publik me<br>-banorë të njësive administrative<br>Balldre, Dajç, Blinisht, Kallmet,<br>Ungrej, Zejmen, Shënkoll, Kolsh.<br>Shëngjin, Lezhë.<br>-biznese lokale,<br>-gazetarë dhe media lokale,<br>- organizata të shoqërisë civile,<br>grupe tjera të interesit. | Për projekt-<br>dokumentin e PBA-së<br>2027-2029 dhe<br>buxhetit vjetor 2027<br>(faza e dytë) | 10.09.2026 | Pallati i Kulturës<br>“Ded Ndue Lazri”,<br>Lezhë | 16:30 | Takim<br>publik |

Rekomandimet për projekt-aktin që do të konsultohet mund t'i dërgoni në adresën e emailit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik në Bashkinë Lezhë [gjystina.nikulaj@lezha.gov.al](mailto:gjystina.nikulaj@lezha.gov.al) si dhe në adresën e sekretares së Këshillit të Bashkisë Lezhë [florida.cunaj@lezha.gov.al](mailto:florida.cunaj@lezha.gov.al) deri me datë 10.09.2026.